

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Nesrin Lushta, kryetare, Emine Mustafa dhe Rasim Rasimi, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Mirlinda Mejzini-Simnica, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër dënuarit T.R., nga Gj., për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike, nga neni 273 par.1 të KPK dhe mbajtja në pronësi, në kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPK, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjilan – DKR, PKR.nr.168/2015 datë 6.6.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - DKR, PAKR.nr.449/2017 datë 3.11.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më 10 prill 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me miratimin e pjesshëm të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, ndryshohen aktgjykimi i Gjykatës Themelore Gjilan – DKR, PKR.nr.168/2015 datë 6.6.2017, dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës - DKR, PAKR.nr.449/2017 datë 3.11.2017, vetëm përkitazi me llogaritjen e arrestit shtëpiak, ashtu që të dënuarit T.R., në dënimin e shqiptuar i llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak prej datës 26.10.2015 gjer më 18.2.2016.

Në pjesën tjetër kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë refuzohet si e pabazuar.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Gjilan – DKR, PKR.nr.168/2015 datë 6.6.2017, i dënuari T.R., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike, nga neni 273 par.1 të KPK dhe mbajtja në pronësi, në kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK, dhe pasi

që më parë për secilën vepër i janë përcaktuar dënimet, është gjykuar me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 21.8.2015 gjer më 25.10.2015 dhe në arrest shtëpiak prej 26.10.2015 gjer më 19.12.2015 dhe me dënim unik me gjobë në shumë prej 300 €, të cilën është i detyruar që të paguajë në afat prej 3 (tre) muajve, çdo muaj nga 100 € e në rast të mos pagesës dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet në pajtim me nenin 46 par.3 të KPK. Është shqiptuar edhe dënimi plotësues konfiskimi i substancës narkotike të llojit mariuhanë në peshë prej 75.80 gr., dhe 4 fishekë të kalibrit 7.65 mm. si dhe 525 € të holla si objekt i veprës penale dhe dobi pasurore të fituar nga vepra penale. Është detyruar që të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 60 €, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjyimit. Me të njëjtin aktgjykim i pandehuri S.N., është liruar nga akuza për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psiko-tropike dhe analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK. Është vendosur që në këtë pjesë shpenzimet e procedurës penale të bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit të Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.449/2017 datë 3.11.2017, duke aprovuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit T.R., ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë vetëm përkitazi me vendimin për dënimin ashtu që të dënuarin pasi që i ka përcaktuar dënimet për secilën vepër veç e veç e ka gjykuar me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj, në të cilin i është llogaritur edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak prej 21.8.2015 gjer më 25.10.2015 dhe dënim me gjobë në shumë prej 300 €.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit T.R., K.S., avokat nga Gj., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen ashtu që i dënuari të lirohet nga akuza ose të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Prokurori i Shtetit të Kosovës, me parashtresën KMLP.II.nr.4/2018 e datës 24.1.2018, ka dhënë përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë duke propozuar që të aprovohet dhe aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen përkitazi me llogaritjen e paraburgimit dhe arrestit shtëpiak në dënimin e shqiptuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes, vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë në pajtim me dispozitën e nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK, dhe konstatoi:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar vetëm përkitazi me shkeljen e ligjit penal.

Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit edhe pse aktgjykimet i kundërshton për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika 1.12 lidhur me nenin 370 të KPPK, nga referati i kërkesës rezulton se aktgjykimet kundërshtohen për shkak të shkeljes së ligjit penal meqë theksohet se është shkelur dispozita e nenit 83 par.1 të KPK.

Nga shkresat e çështjes dhe aktgjykimet e kundërshtuara rezulton se i dënuari T.R., është shpallur fajtor se ditën kritike më 21.8.2015 rreth orës 13:30 tek Penda e fshatit L., komuna e Gj., ka poseduar substancë narkotike të llojit mariuhanë në peshë prej 75.80 gr., e cila ka qenë e dedikuar për shitje. Me këtë rast i dënuari T.R., substancën narkotike të përgatitur në një qese të mbështjellë me ngjitës, e kishte vendosur afër vendit kur ishte zënë gjatë kontrollit rutinor nga Policia e Kosovës. Nga shkresat e çështjes rezulton se njësi policor ditën kritike kishte qenë në përcjelljen dhe vrojtimin e të dënuarit T.R., meqë kishin informacione se i njëjti posedon dhe do të ndodhë shitja e substancës narkotike, kështu që i dënuari po atë ditë ishte zënë në flagrancë nga policia.

Janë të bazuara pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë se në rastin konkret është shkelur dispozita e nenit 83 të KPK për faktin se siç rezulton nga aktgjykimet e kundërshtuara dhe shkresat e çështjes në dënimin e shqiptuar, të dënuarit nuk i është llogaritur koha e tërësishme e kaluar në arrest shtëpiak por vetëm një pjesë të saj.

Nga shkresat e çështjes rezulton se me aktvendimin e Gjykatës Themelore Gjilan, PPR.KR.nr.122/2015 datë 22.8.2015, ndaj të dënuarit T.R., është caktuar paraburgim i cili i ka zgjatuar gjer më 26.10.2015 ndërsa me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Pn1.nr.1861/2015 datë 26.10.2015, i është zëvendësuar masa e paraburgimit në masën e arrestit shtëpiak e cila ka zgjatuar gjerë me 18.2.2016. Me aktvendimin Gjykatës së Apelit të Kosovës PKR.nr.168/2015 datë 18.2.2016, kjo masë është zëvendësuar me masën e paraqitjes në stacionin policor.

Prandaj, meqë të dy gjykatat nuk e kanë llogaritur këtë kohë të cilën i dënuari ka kaluar në arrest shtëpiak siç e obligon dispozita e nenit 83 të KPK, respektivisht periudhën kohore prej 26.10.2015 gjerë më 18.2.2016, kjo Gjykatë e aprovoj pretendimet në fjalë dhe e ndryshoi aktgjykimin e kundërshtuar si në pikën I të dispozitivit meqë është shkelur dispozita e nenit 385 par.1 pika 1.6 të KPPK.

Pjesa tjetër e kërkesës, ka të bëjë me shkelje të nenit 69 të KPK, lidhur me shqiptimin e dënimit plotësues, konfiskimin e shumës së të hollave prej 525 €, e cila shumë sipas pretendimeve nga kërkesa, nuk është rezultat i veprës penale. Në kërkesë thuhet se ato janë konfiskuar pa kurrfarë baze ligjore sepse gjykata nuk ka vërtetuar se ato rrjedhin nga vepra penale. Sipas pretendimeve nga kërkesa ato rrjedhin nga shitblerja e automjetit "T...", e bërë disa ditë para ditës kritike

respektivisht më 14.8.2015 për çfarë i dënuari gjykatës së shkallës së parë i ka prezantuar një kupon.

Gjykata Supreme, vlerëson se ky pretendim nuk është i bazuar për faktin se pretendimi në fjalë, është ngritur në fazën e shqyrtimit gjyqësor, për çfarë gjykata e shkallës së parë në faqen 4 të aktgjykimit ka dhënë arsye të qarta ligjore. Arsyet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë si të drejta i pranon edhe kjo Gjykatë për arsye se prova e dorëzuar nga i dënuari në formë të një kuponi me dorëshkrim për gjoja shitblerjen e veturës, nuk e ka fuqinë e provës meqë nuk i përmbush atributet e një dokumenti valid por kemi të bëjmë me një shkresë e cila nuk vërteton asnjë fakt relevant, siç drejt ka konkluduar gjykata e shkallës së parë.

Nga sa u tha më sipër e në pajtim me dispozitën e nenit 438 par.1 pika 1.1 dhe 437 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË
Pml.nr. 9/2018, më 10 prill 2018

Procesmbajtësja,
Mirlinda Mejzini-Simnica

Kryetare e kolegjit,
Nesrin Lushta